



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Bregu i Diellit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +381 38 552 126 ext.101 • E-mail: fim@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1725
 Datë: 03/10 / 2023

- Për: **Këshillin e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike**
- Nga: **Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa**
- Lënda: Shqyrtimi i ankesave të kandidatëve në lidhje me Konkursin Plotësues për Angazhim të Bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", për vitin akademik 2023-24 me Nr. Prot: 1/909 i datës 1.08.2023, pika VII për Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, respektivisht pozitat 2, 3, 4 dhe 6.

RAPORT

Nga Administrata e FIM Komisioni ka pranuar 4 ankesa në vendimet e Komisioneve vlerësuese të Konkursit Plotësues për Angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", për vitin akademik 2023-24 me Nr. Prot: 1/909 i datës 1.08.2023, respektivisht pozita 2 (Një bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime, për lëndët Gjuhë Angleze 1 dhe 2), pozita 3 (Një bashkëpunëtorë të jashtëm për ligjërata, për lëndët Gjuhë Gjermane 1 dhe 2), pozita 4 (Një bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime, për lëndët Gjuhë Gjermane 1 dhe 2) dhe pozita 6 (Tre bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime, për lëndët Grafika Inxhinierike, Mekanika Teknike 1, Statika, dhe Vizatimi me Kompjuter).

Në mbledhjen e mbajtur me 03.10.2023, Komisioni për ankesa dhe parashtresa ka shqyrtuar ankesat e kandidatëve dhe jep këto vlerësime:

I. Ankesa e kandidatës Nora Bajrami me nr. Protokolli 08. 1636 e datës 25. 09. 2023, e dorëzuar në FIM, lidhet me pozitën 6 të konkursit.

Kandidatja Nora Bajrami në ankesën me Nr. 08.1636 të datës 25. 09. 2023 pretendimit kryesore i ka ne këto pika:

- Komisioni nuk e ka vlerësuar përvojën e punës;
- Nota mesatare Bachelor dhe Master është më e lartë se e kandidatëve tjerë, përfshirë moshën që është më e re se kandidatët tjerë,
- Po ashtu vlerëson se komisioni ka marre vendim në bazë të diskrecionit të tij.
- Kohëzgjatja e afatit të ankesave ka qenë 5 ditë.

Përgjigja e komisionit të Ankesave:

Komisioni ankesave kontaton se komisioni vlerësues duke u mbështetur në Rregulloren e Procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, nr. Prot.: 1/95, të datës 24.06.2021, **ka vlerësuar drejtë kandidaten.**

1. Kandidatja nuk ka ofruar asnjë dokument të dëshmisë për përvojë të punës.
 - **Në konkursin e shpallur Nr. Prot: 1/909 i datës 1.08.2023 në piken V. h dhe V. j kërkohet të dëshmohet përvoja (dokumente).**
2. Kandidatja nuk ka përvojë në mësimdhënie sipas kërkesave në nenit 3 të Rregullores për Angazhimin e Bashkëpunëtorëve të Jashtëm **Nr. Prot. 1/95 e datës 24.06.2021.**
 - **Neni 3 i rregullores Nr. Prot. 1/95 e datës 24.06.2021, përfshin procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm ku kërkohet: Aktiviteti mësimor (ligjërata e ushtrime), konsultime dhe mbajtje të provimeve.**
3. Kandidatja Nora Bajrami e plotëson kriterin e notës mesatare, neni 7 (pika 3.2), siç i plotësojnë edhe kandidatët tjerë.
 - **Komisioni vlerësues vlerësimin përfundimtar e ka dhënë në harmoni me nenin 7 (pika 4) ku caktohen prioritetet e përzgjedhjes.**
 - 4.1 Kandidati me përvojë më të gjatë në fushën përkatëse;**
 - 4.2 Kandidati i gjinisë femërore;
 - 4.3 Në rastet tjera mbetet në diskrecionin e komisionit vlerësues dhënia e përparësisë së kandidatit të caktuar.
4. Lidhur me kohëzgjatjen e afatit të ankesave, komisioni i ankesave ka pranuar përgjigje nga sekretarja e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, se afati i ankesave në dispozicion ka qenë me kohëzgjatje prej 8 ditëve (gabimi teknik në webfaqe është përmirësuar pa u mbyllur afati 5 ditor) <https://fim.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,37,1234>

Konsiderojmë se ankesa e kandidatës është e pabazuar.

II. Ankesa e kandidatës Valona Asllani nr. Prot. 08.1639 e datës 25. 09. 2023, e dorëzuar në FIM, lidhet me pozitën 4 të konkursit.

Kandidatja **Valona Asllani** është ankuar se:

- Komisioni nuk i ka dhënë përparësi edhe pse e ka notën mesatare më të lartë se kandidatët tjerë, në të dy nivelet;
- Nuk i është vlerësuar drejtë kohëzgjatja e përvojës së punës;
- Vendimi nuk i përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ dhe është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e nenin 47 të ligjit 05L-031;
- Kohëzgjatja e afatit të ankesave ka qenë 5 ditë.

Përgjigja e komisionit të Ankesave:

Pas verifikimit të dokumentacionit të nevojshëm për aplikim, komisioni i ankesave ka dhënë këtë vlerësim:

- Në bazë të dëshmive të ofruara në dosjen e kandidatës **Valona Asllani**, gjegjësisht kontratës së punës në arsimin e lartë të lëshuar nga Universiteti Publik i Prizrenit me Nr. Protok. 05-286, datë 09.11.2022, kandidatja ka përvojë në kohëzgjatje prej një semestri (3.5 muaj), por në Vërtetimin e lëshuar nga Universiteti Publik i Prizrenit me nr. Prot. 05-206, datë 23.08.2023, shkruan se kandidatja ka edhe një angazhim shtesë një semestral në kohëzgjatje 3.5 muaj (16.02.2023-31.05.2023). **Në bazë të këtyre dëshmive kandidatja Valona Asllani ka përvojë dy semestrale me kohëzgjatje 7 muaj.**
- Nga ana tjetër, në bazë të dëshmive të ofruara në dosjen e kandidatës **Uridije Lajqi**, gjegjësisht kontratës së punës në arsimin e lartë me Nr. Prot. 4/545, datë 21.11.2022, **kandidatja Uridije Lajqi ka përvojë pune në mësimdhënie në arsimin e lartë vetëm një semestër me kohëzgjatje 3.5 muaj.**
- **Sa i përket përmbajtës së vendimit të këshillit në raport me ligjit 05L-031 nenin 47, komisioni i ankesave konsideron se nuk është kompetent në interpretimin e tij.**
- Lidhur me kohëzgjatjen e afatit të ankesave, komisioni i ankesave ka pranuar përgjigje nga sekretarja e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, se afati i ankesave në dispozicion ka qenë me **kohëzgjatje prej 8 ditëve** (gabimi teknik në webfaqe është përmirësuar pa u mbyllur afati 5 ditor)

<https://fim.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,37,1234>

- Referuar rregullores Nr. Prot. 1/95 e datës 24.06.2021, gjegjësisht nenit 7 pika 4 për përcaktimin e prioriteteve në përzgjedhjen e kandidatëve, kur dy e më shumë i plotësojnë kushtet përzgjedhja bëhet sipas këtij prioriteti: të cilët i plotësojnë kushtet formale

4.1 Kandidati me përvojë më të gjatë në fushën përkatëse;

4.2 Kandidati i gjinisë femërore;

4.3 Në rastet tjera mbetet në diskrecionin e komisionit vlerësues dhënia e përparësisë së kandidatit të caktuar.

Pas rivlerësimit të kandidatëve nga ana e komisionit të ankesave, radhitja e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet për praninë në pozitën 4 (Një bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime, për lëndët Gjuhë Gjermane 1 dhe 2), në përputhje me rregulloren Nr. Prot. 1/95 e datës 24.06.2021 është si në vijim:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grada shkencore	Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata				Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime			Moshë (datëlindja)	Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet)	Bie ndesh me Nenin 7, paragrafi 10. Rregullorja Nr. 1/95, e datës 24/06/2021 (PO/JO)	Propozohet të angazhohet (PO/JO)
			Thirrja akademike	Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me kriteret e Statutit dhe Rregulloren në fuqi për emërimin e personelit akademik	Përvoja e punës profesionale në mjetësinë tregtare (Fakulteti i Mjetësisë)	Nota Ba.	Nota Ma.	Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e Mjekësisë					
1	Elton Krivonjeva	MSc	/	/	/	8.32	8.84	/	28 (28.01.1995)	2 vite	JO	PO	
2	Valona Asllani	MSc	/	/	/	9.23	9.71	/	26 (23.07.1997)	7 muaj	JO	JO	
3	Uridije Lajqi	MSc	/	/	/	9.1	9.73	/	26 (08.06.1997)	3.5 muaj	JO	JO	

Kandidatja MSc Mirjeta Kuçi nuk e plotëson kriterin e moshës sipas rregullores UP me nr. Nr. Prot. 1/95 e datës 24.06.2021, neni 7 pika 3.3.

III. **Ankesa e Kandidates Mirjeta Kuçi** nr. Prot. 08.1643 e datës 25. 09. 2023, e dorëzuar në FIM dhe që lidhet me pozitën 3 të konkursit.

Kandidatja **Mirjeta Kuçi** ankohet në vendimin e Komisionit vlerësues me pretekst se është eliminuar padrejtësisht **për shkak të zbatimit të kriterit të moshës për pozitën e ligjëruesit.**

Përgjigja e komisionit te Ankesave:

Pas verifikimit të dokumentacionit të nevojshëm për aplikim, komisioni i ankesave ka konstatuar se:

- **Referuar rregullores Nr. Prot. 1/95 e datës 24.06.2021, gjegjësisht nenit 7 pika 2, nuk përfshihet kriteri i moshës në përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata.**

Prandaj, komisioni i ankesave vlerëson se ankesa e kandidatës **është e bazuar.**

Pas rivlerësimit të kandidatëve nga ana e komisionit të ankesave, radhitja e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet për praninë në pozitën 3 (Një bashkëpunëtorë të jashtëm për ligjërata, për lëndët Gjuhë Gjermane 1 dhe 2), në përputhje me rregulloren Nr. Prot. 1/95 e datës 24.06.2021, është si vijon:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grada shkencore	Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata			Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime			Moshë (datëlindja)	Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet)	Bie ndesh me Nenin 7, paragrafi 10, Rregullorja Nr. 1/95, e datës 24/06/2021 (PO/JO)	Propozohet të angazhohet (PO/JO)
			Thirrja akademike	Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me kriteret e Statutit dhe Rregulloren në fuqi për emërimin e personelit akademik	Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë)	Nota Ba.	Nota Ma.	Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e Mjekësisë				
1	Mirjeta Kuçi	MSc	/	/	/	9.07	8.93	/	38 (08.09.1985)	2 vite e 4 muajt	JO	PO
2	Elton Krivonjeva	MSc	/	/	/	8.32	8.84	/	28	2	JO	JO

									(28.01.19 95)			
3	Valona Asllani	MSc	/	/	/	9.23	9.71	/	26 (23.07.19 97)	7 mua j	JO	JO
4	Uridije Lajqi	MSc	/	/	/	9.1	9.73	/	26 (08.06.19 97)	3.5 mua j	JO	JO

IV. **Ankesa e Kandidates Arta Sejdiu** nr. Prot. 08.1679 e datës 28.09.2023, e dorëzuar në FIM lidhet me pozitën 2 të konkursit.

- Kandidatja **Arta Sejdiu** ankohet në vendimin e Komisionit vlerësues, se dosja e saj nuk është marrë për bazë gjatë vlerësimit të kandidatëve. Sipas ankesës së saj dosja nuk është përcjell fare nga administrata qendrore e UP-së tek administrata e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.
- Kandidatja pretendon se ka dy vite përvojë pune si ligjëruese në Kosovë dhe gati dy vite përvojë pune si ligjëruese në Amerikë.

Përgjigja e komisionit te Ankesave:

Në bazë të kërkesës së dekanit të FIM-it drejtuar drejtorit të administratës së UP-së Gazmend Shabaj, pas ankesës së kandidatës për mos shqyrtimin e aplikimit të saj (Arta Sejdiu), drejtori i administratës Gazmend Shabaj është përgjigjur përmes e-mailit, citim: “I nderuar dekan, Arta Sejdiu ka aplikuar në disa fakultete, duke përfshirë edhe ne Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, dosjen e te cilës ta përcjella!” , me datë 29.09.2023.

Pas rivlerësimit të dosjes së kandidatës Arta Sejdiu, komisioni konstaton se :

- kandidatja **Arta Sejdiu** nuk e plotëson kriterin e notës mesatare në Bachelor sipas Neni 7 pika 3.2 të rregullores Nr. Prot. 1/95 e datës 24.06.2021 për përzgjedhje si bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime.

Prishtinë, 03.10.2023

Komisioni për ankesa dhe parashtresa

1. Prof. ass. Ferit Idrizi



2. Prof. ass. Shkelzen Shabani



3. Prof. ass. Gëzim Hoxha





UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I INXHNIERISË MEKANIKE

Rruga Agim Ramadani, Ndërtesa e Fakulteteve Teknike, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 552 126 ext. 101 * E-mail: fim@uni-pr.edu * www.fim.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1743

Date: 04.10.2023

Në bazë të nenit 75, 76 dhe 173 të Statutit të UP-së, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës; Rregulloren e Procedurave Vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP, Nr. 1/95, të datës 24.06.2021, konkursin Nr. Prot. 1/909, të datës 01.08.2023, Këshilli i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në mbledhjen e mbajtur me 04.10.2023, ri-shqyrtoi Raportet e Komisioneve vlerësuese dhe Raportit të komisionit për ankesa Nr. Prot. 1725 dt. 03.10.2023.

Në afatin prej 8 ditësh FIM ka pranuar 4 (katër) ankesa lidhur me Raportet e komisioneve vlerësuese.

- I. Ankesa Nr. Prot. 1636 datë 25.09.2023 nga kandidatja **Nora Bajrami**, për pozitën Nr. 6 Tre bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime, për lëndët: Grafika Inxhinierike, Mekanika Teknike I, Statika, dhe Vizatim me kompjuter.
Komisioni i ankesave ka shqyrtuar ankesën dhe ka ardhur në përfundim që ankesa **është e pabazuar**.
- II. Ankesa Nr. Prot. 1639 datë 25.09.2023 nga kandidatja Valona Asllani, për pozitën Nr. 4 Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët Gjuhë gjermane 1 dhe 2.
Komisioni i ankesave ka shqyrtuar ankesën dhe ka ardhur në përfundim që ankesa **është e bazuar** dhe ri-shqyrtuar aplikacionet e të gjithë kandidatëve sipas Rregullosës 1/95 dt. 24.06.2021, neni 7, pika 4, përkatësisht **4.1 Kandidati me përvojë më të gjatë në fushën përkatëse**; ka nxjerrë renditjen e kandidatëve për këtë pozitë si në vijim:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grada shkencore	Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata			Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime			Moshë (datëlindja)	Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet)	Bie ndesh me Nenin 7, paragrafi 10, Rregullorja Nr. 1/95, e datës 24/06/2021 (PO/JO)	Propozohet të angazhohet (PO/JO)
			Thirrja akademike	Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me kriteret e Statutit dhe Rregulloren në fuqi për emërimin e personelit akademik	Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë)	Nota Ba.	Nota Ma.	Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e Mjekësisë				
1	Elton Krivonjeva	MSc	/	/	/	8.32	8.84	/	28 (28.01.1995)	2 vite	JO	PO
2	Valona Asllani	MSc	/	/	/	9.23	9.71	/	26 (23.07.1997)	7 muaj	JO	JO
3	Uridije Lajqi	MSc	/	/	/	9.1	9.73	/	26 (08.06.1997)	3.5 muaj	JO	JO

Këshillit i propozohet zgjedhja e **Msc. Elton Krivonjeva** (sipas kriterit të përvojës më të gjatë në fushën përkatëse) për bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët Gjuhë gjermane I dhe II.

- III. Ankesa Nr. Prot. 1643 datë 25.09.2023 nga kandidatja Mirjeta Kuçi, për pozitën Nr. 3 Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata, për lëndët Gjuhë gjermane I dhe II. Komisioni i ankesave ka shqyrtuar ankesën dhe ka ardhur në përfundim që ankesa **është e bazuar**, dhe ka ri-shqyrtuar aplikacionet e të gjithë kandidatëve sipas Rregullores 1/95 dt. 24.06.2021, neni 7, pika 2, ku nuk përfshihet **kriteri i moshës për ligjërues**, ka nxjerrë renditjen e kandidatëve për këtë pozitë si në vijim:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grada shkencore	Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata			Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime			Moshë (datëlindja)	Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet)	Bie ndesh me Nenin 7, paragrafi 10, Rregullorja Nr. 1/95, e datës 24/06/2021 (PO/JO)	Propozohet të angazhohet (PO/JO)
			Thirrja akademike	Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me kriteret e Statutit dhe Rregulloren në fuqi për emërimin e personelit akademik	Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë)	Nota Ba.	Nota Ma.	Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e Mjekësisë				
1	Mirjeta Kuçi	MSc	/	/	/	9.07	8.93	/	38 (08.09.1985)	2 vite e 4 muaj	JO	PO
2	Elton Krivonjeva	MSc	/	/	/	8.32	8.84	/	28 (28.01.1995)	2 vite	JO	JO
3	Valona Asllani	MSc	/	/	/	9.23	9.71	/	26 (23.07.1997)	7 muaj	JO	JO
4	Uridije Lajqi	MSc	/	/	/	9.1	9.73	/	26 (08.06.1997)	3.5 muaj	JO	JO

Këshillit i propozohet zgjedhja e **Msc. Mirjeta Kuçi** (sipas kriterit të përvojës më të gjatë në fushën përkatëse) për bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata, për lëndët Gjuhë gjermane I dhe II.

- IV. Ankesa Nr. Prot. 1679, datë 28.09.2023 nga kandidatja Arta Sejdiu, për pozitën Nr. 2 Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët Gjuhë angleze I dhe II. Komisioni i ankesave ka shqyrtuar ankesën dhe ka ardhur në përfundim që aplikacioni i Arta Sejdiu nuk ka ardhur nga Administrata qendrore e UP-së në FIM. Dekani e ka kërkuar këtë aplikacion dhe i njëjti është përcjellë te komisioni i ankesave. Pra ankesa **është e bazuar**, dhe komisioni ka ri-shqyrtuar aplikacionet e të gjithë kandidatëve sipas Rregullores 1/95 dt. 24.06.2021 për këtë pozitë dhe konstaton se kandidatja Arta Sejdiu nuk e plotëson kriterin eliminues të notës mesatare së paku 8.00 në të dy nivelet Bachelor dhe Master. Bazuar në këtë mbetet në fuqi zgjedhja e **Msc. Lorita Fejza** për bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët Gjuhë angleze I dhe II.

Këshilli i FIM-së në mbledhjen e mbajtur me 04.10.2023 e ka aprovuar në tërësi Raportin e komisionit për ankesa Nr. Prot. 1725 të datës 03.10.2023.

Bazuar në ato që u prezantuan më lartë Këshilli i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata / ushtrime

Pozita:

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata për lëndët: *Gjuhë angleze I dhe II*.
 - Zgjedhet: Dr. Halil Asllani
2. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: *Gjuhë angleze I dhe II*.
 - Zgjedhet: Msc. Lorita Fejza
3. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ligjërata, për lëndët: *Gjuhë Gjermane I dhe II*.
 - Zgjedhet: Msc. Mirjeta Kuçi
4. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndët: *Gjuhë Gjermane I dhe II*.
 - Zgjedhet: Msc. Elton Krivonjeva
5. Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, për lëndën: *Fizika*.
 - Nuk ka kandidatë të paraqitur.
6. Tre bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime, për lëndët: *Grafika Inxhinierike, Mekanika Teknike I, Statika, dhe Vizatim me kompjuter*. Zgjedhën:
 - Msc. Egzon Qorraj
 - Msc. Fidan Smajli
 - Msc. Qendrim Bruçi
7. Tre bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime, për lëndët e programit: *Dizajn Inxhinierik dhe Automjete (Bsc dhe Msc)*. Zgjedhën:
 - Msc. Donjeta Sogojeva
 - Msc. Fatlume Zhujani
8. Katër bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime, për lëndët e programeve: *Termoenergjetikë dhe Energji e Ripërtërishme (Bsc dhe Msc)*. Zgjedhën:
 - Dr. sc. Blerina Bylykbashi
 - Dr. sc. Gazmend Krasniqi
 - Msc. Korab Krasniqi
 - Msc. Meriton Berisha
9. Dy bashkëpunëtorë të jashtëm për ushtrime, për lëndët e programeve: *Mekatronikë (Bsc dhe Msc)*, Zgjedhën:
 - Dr. sc. Astrit Hulaj
 - Msc. Lum Rexha

Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të fillojë konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, ashtu siç e parasheh edhe konkursi Nr. Prot. 1/909, datë 01.08.2023 Kreu VI, Pika 7.

Me këtë Vendim njoftohen:


Senati i UP-së

Zyra për çështje akademike e UP-së

Shërbimi profesional i Fakultetit.

Vendimi së bashku me Raportin e Komisionit për ankesa të publikohet në website të FIM-së

Prishtinë, 04.10.2023

Dekani

Prof. Dr. Ahmet Shala

